



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr.2, Datë 01.04.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetar |
| - Z. Bashkim Sykja | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2010, mori në shqyrtim praktikën e mos-dorëzimit të faturave nga ana e operatorit të telefonisë fikse Albelekom sh.a në vendbanimin e konsumatorëve. Megjithëse operatori Albelekom sh.a është njoftuar për fillimin e procedimit administrativ si dhe është ftuar të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit me shkresë nr.prot 3, datë 25.03.2010, nuk u paraqit asnjë përfaqësues i tyre.

Komisioni pas shqyrtimit të rastit,

VËREN SE:

Praktika e ndjekur nga operatori Albelekom sh.a, duke mos pajisur konsumatorët me faturat përkatëse në vendbanimet e tyre, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, neni 40, pika 5, sipas të cilit : *“Faturat duhet t'i dorëzohen konsumatorit në vendin e banimit, në mënyrë zyrtare (me postë ose dorazi) dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së tyre”*.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 40, pika 5 dhe nenin 55, të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/c të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 ”Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”

VENDOSI:

1. Të gjobisë operatorin Albtelekom sh.a me 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lek, për kundravajtjen administrative si rrjedhojë e shkeljes së nenit 40 të ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.
2. Ndalimin e shkeljes nga ana e operatorit Albtelekom sh.a.
3. Faturimi për shërbimin e telefonise fikse, për muajin prill 2010, e në vazhdim nga ana e operatorit Albtelekom sh.a, të bëhet konform ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.
4. Publikimi i këtij vendimi të bëhet në përputhje me nenin 55, pika ç të ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI